



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

PROKURORIA E PERGJITHSHME

Nr. 405 Prot. Dt. 26.2.2003

Nr. 32 Prot. Dt. 12.2.2003

**UDHËZIM I PËRBASHKËT**

**Për funksionimin e Policisë Gjyqësore në  
Policinë e Shtetit dhe Seksionin e Prokurorisë.**

Mbështetur në nenin 102-4, dhe 118-2 të Kushtetutës, Ligjit nr. 8737 dt. 12.02.2001 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë*", Ligjit Nr.8677 dt. 02.11.2000 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore*", Ligjit Nr.8553 dt.25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

Me synim

- Organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit.
- Unifikimin e praktikës dhe forcimin e raporteve të Prokurorisë me Policinë Gjyqësore.
- Rritjen e përgjegjësisë së Prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në hetimet paraprake gjykimin e procedimeve dhe ekzekutimin e vendimeve penale:

**UDHËZOJMË:**

-1) Hetimet paraprake kryhen nga Policia Gjyqësore me iniciativë ose urdhër të Prokurorit nën drejtimin dhe kontrollin e Prokurorit.

2) Prokurori drejton dhe kontrollon hetimet paraprake të Policia Gjyqësore dhe kur e çmon të nevojshme kryen vetë veprime hetimore sipas kompetencave të përcaktuara në K. Pr. Penale.

3) Veprimtaria e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit realizohet nga shërbimet e ngritura në këtë Polici.

a)- Shërbimet e Policisë Gjyqësore.

1) Atributet e Policisë Gjyqësore ushtrohen nga punonjësi i Policisë së Shtetit që në momentin që ai merr informacion për ekzistencën e veprës penale. Punonjësi i Policisë së Shtetit në rolin e mesëm dhe të lartë ushtron funksionet e oficerit të policisë gjyqësore, ndërsa ai i rolit bazë ushtron funksionet e agjentit të Policisë Gjyqësore.

2) Janë shërbime të policisë gjyqësore, sipas kompetencave tokësore, këto struktura të komisariateve të policisë në rrethe:

- Seksione të Policisë Kriminale;
- Nëseksionet e Policisë Kufitare;
- Nëseksionet e Policisë Rrugore.
- Seksionet e Policisë së Rendit

a) Drejtues të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, të përmendura në pikën 2 të këtij Udhëzimi, respektivisht janë:

- Shefat e Seksioneve të Policisë Kriminale; -
- Shefat e Nëseksioneve të Policisë Kufitare; -
- Shefat e Nëseksioneve të Policisë Rrugore. -
- Shefat e Seksioneve të Policisë së Rendit

b) Shefat e Komisariateve ne rrethe kanë statusin e drejtuesit të Policisë gjyqësore e përgjigjen para prokurorëve respektivë, për mbarëvajtjen e punës dhe realizimin e detyrave prej drejtuesve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore që varen prej tyre.

3) Janë shërbime të posaçme të Policisë" Gjyqësore sipas kompetencave lëndore duke vepruar në nivel qarku, këto struktura të drejtorive të policisë në qarqe:

- Zyrat rajonale të Luftës Kundër Krimeve antikushtetuese dhe akteve terroriste;
- Zyrat rajonale të Luftës Kundër Krimeve të drogës;
- Zyrat rajonale të Luftës Kundër Krimin Ekonomik - Financiar;
- Zyrat rajonale të Krimeve të Rënda Kundër Personit;
- Zyrat rajonale Kundër Trafikeve të Paligjshme;
- Zyrat e Gjurmimit Teknik.

a) Drejtues të shërbimeve te policisë gjyqësore, të përmendura në pikën i të këtij Udhëzimi, respektivisht janë:

- Shefat e zyrave rajonale të Luftës Kundër Krimeve Antikushtetuese dhe Akteve Terroriste;
- Shefat e zyrave rajonale të Luftës Kundër Krimeve të Drogës;
- Shefat e zyrave të Luftës Kundër Krimin Ekonomik - Financiar;

- Shefat e zyrave të Krimeve të Rënda Kundër Personit;
- Shefat e zyrave Kundër Trafikeve të Paligjshme;
- Shefat e zyrave të Gjurmimit Teknik.

54

b) Drejtorët dhe shefat e sektorëve të policisë kriminale në drejtoritë e policisë në qarqe, kanë statusin e drejtuesit të shërbimeve të policisë gjyqësore e përgjigjen para prokurorëve respektivë për mbarëvajtjen e punës dhe realizimin e detyrave prej drejtuesve të shërbimeve të policisë gjyqësore vartës të tyre.

4) Janë shërbime të posaçme të Policisë Gjyqësore këto struktura të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit:

-Sektori i Krimeve Kundër Krimeve Antikushtetuese dhe Akteve Terroriste;

- Shërbimi Qendror i Luftës Kundër Drogës;
- Sektori i Luftës Kundër Krimit Ekonomik- Financiar;
- Sektori i Krimeve Kundër Personit dhe Pasurisë;
- Sektori i Luftës Kundër Trafikeve të Paligjshme;
- Sektori I Operacioneve Speciale;
- Sektori i Hetimeve të Posaçme.

a) Drejtues të policisë gjyqësore, të përmendura në pikën 4 të këtij Udhëzimi, respektivisht janë:

- Shefi i Sektorit të Luftës Kundër Krimeve Antikushtetuese dhe akteve terroriste;
- Shefi i Shërbimit Qendror i Luftës Kundër Drogës;
- Shefi i Sektorit të Luftës Kundër Krimit Ekonomik-Financiar;
- Shefi i Sektorit të Luftës Kundër Personit e Pasurisë;
- Shefi i Sektorit të Luftës Kundër Trafikeve të Paligjshme;
- Shefi i Operacioneve Speciale;
- Shefi i Sektorit të Hetimeve të Posaçme.

b) Shërbimet e policisë gjyqësore të përmendura në pikën 4 të këtij Udhëzimi, kryejnë funksione të Policisë Gjyqësore sipas drejtimeve që kanë në të gjithë territorin e vendit.

4/1) Në Ministrinë e Rendit Publik Sektori i Policisë Gjyqësore në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm ka atributet e Policisë Gjyqësore dhe Shefi i këtij Sektori është Drejtuesi i Policisë Gjyqësore për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm.

5) Shërbimet e Policisë Gjyqësore në veprimtarinë e tyre ruajnë hierarkinë sipas ndërtimit administrativ të strukturave të policisë së shtetit.

6) Drejtuesit e shërbimeve të Policisë Gjyqësore të të gjitha niveleve

përgjigjen para prokurorëve respektivë dhe eprorëve të tyre, për organizimin administrativ të punës të oficerëve dhe agjentëve që kryejnë detyrat e policisë gjyqësore, për administrimin e proceseve hetimore, mbajtjen e sekretit të hetimit, zvarritjet e procesit të hetimit paraprak, zbulimin dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale në përputhje me kërkesat e K. Pr. Penale.

7) Oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore zhvillojnë hetime sipas drejtimeve të funksioneve të tyre bazë, duke zbatuar urdhrat e Prokurorit dhe duke bashkëpunuar midis sektorëve brenda policisë dhe seksionit të policisë gjyqësore në Prokurori.

8) Për ngjarjet kriminale të ndodhura njoftohet nga policia menjëherë Prokurori i rrethit ose prokurori i gatshëm në rreth. Shefi i seksionit ose zyrës rajonale sipas kompetencës lëndore që ndjek veprat penale, organizon grupin hetimor dhe shkon në vendin e ngjarjes dhe bën këqyrjen e vendit të ngjarjes. Oficeri i shërbimeve të policisë gjyqësore (shefi i seksionit, i zyrës rajonale ose personi ngarkuar prej tij) së bashku me ekspertin kriminalist përgjigjen për cilësinë dhe saktësinë e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe administrimit të provave materiale. Pas këqyrjes së vendit të ngjarjes policia gjyqësore vazhdon veprimet hetimore me iniciativë.

9) Në ngjarjet kriminale që mund të ndodhin në komisariat ose ambientet e policisë dhe kur subjekte të veprës penale janë punonjës të Policisë së Shtetit, shërbimet e policisë gjyqësore ruajnë vendin e ngjarjes dhe këqyrja e vendit të ngjarjes dhe veprimet hetimore kryhen nga Prokurori ose oficeri I policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë,

10) Në krimet e rënda duhet të marrë pjesë prokurori i gatshëm, kryesisht në vrasjet, vjedhjet me thyerje të bankave ose me pasojë vdekje, arkave të kursimeve dhe aksidenteve automobilistike me pasojë vdekje.

11) Shefi i seksionit ose zyrës rajonale, për ngjarjet kriminale që ka udhëhequr hetimin në rastet e ndalimit ose arrestimit në flagrancë, njofton menjëherë Prokurorin dhe jo më vonë se 24 orë nga ndalimi ose arrestimi, dorëzon aktet procedurale në Prokurori dhe vazhdon hetimet së bashku me oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore me iniciativë dhe urdhër të Prokurorit.

12) Dorëzimi në Prokurori dhe marrja nga Prokurori i fashikullit të hetimit kryhet nga shefi i seksionit ose zyrës rajonale kundrejt nënshkrimit në regjistrin e Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore,

13) Fashikulli i procedimit penal mbahet dhe ruhet nga Policia Gjyqësore që zhvillon hetimet dhe i vihet në dispozicion prokurorit sa herë që kërkohet prej tij.

14) Pasi kryhen veprimet e nevojshme hetimore, oficerët e policisë gjyqësore që kanë zhvilluar hetimin dhe shefi i seksionit ose zyrës rajonale (drejtuesi i tyre), analizojnë procedimin penal tek Prokurori që drejton dhe kontrollon hetimet. Ne qoftë se konkludohet se hetimet janë kryer të plota, policia gjyqësore i dërgon fashikullin e procedimit penal prokurorit, bashkë me një relacion shpjegues për faktin, provat dhe sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve.

#### Detyrat e seksionit të policisë gjyqësore në Prokurori.

1) Oficerët e policisë gjyqësore të policisë së Shtetit të emëruar në seksion të Prokurorisë, ushtrojnë funksionet e policisë gjyqësore në zyrat e Prokurorisë nën drejtimin dhe kontrollin e Prokurorit. Kur kjo nuk është e mundur për mungesë të ambienteve të nevojshme ushtrojnë funksionet në zyrat e komisariateve të caktuara posaçërisht për ata.

2) Oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve çdo ditë paraqiten në zyrat e Prokurorisë për të filluar punën ose për të marrë detyrat e urdhëruara me shkrim ose me gojë sipas rastit, nga Prokurori. Ata nuk mund të ngarkohen me detyra të tjera nga drejtuesit e policisë së shtetit, përveç rasteve të stërvitjes për të cilat njoftohet dhe merret pëlqimi i drejtuesit të Prokurorisë.

3) Oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë si rregull hetojnë veprat penale ku procedimi penal ka nisur mbi bazë kallëzimi.

Në rastet që çmon prokurori oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve mund të hetojnë vepra penale mbi bazë të ngjarjeve kriminale ose në grupe të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve.

4) Prokuroritë e rretheve detyrohen të pajisin me mjete pune, (dosje, formularë, kancelari), oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve.

5) Shefat e komisariateve detyrohen të pajisin me radio dore dhe çdo pajisje tjetër që i takon oficerit të policisë gjyqësore të seksionit.

Në raste shërbimi për kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara nga Prokurori, shefat e komisariateve detyrohen t'u vënë në dispozicion automjete dhe tu paguajnë dietat oficerëve të policisë gjyqësore, të policisë së shtetit në seksionin e Prokurorisë.

6). Fashikujt e procedimeve penale që heton policia gjyqësore e seksioneve do të jenë të regjistruara në regjistrin e procedimeve penale te Prokurorisë. Ato do të merren me firmë nga oficeri i policisë gjyqësore në Sekretarinë e Prokurorisë dhe dorëzimi bëhet me firme në Sekretarinë e Prokurorisë.

7) Pasi kryhen veprimet hetimore të urdhëruara nga Prokurori ose me iniciativë, oficeri i policisë gjyqësore të seksionit, analizon çështjen tek Prokurori që drejton hetimet dhe nëse hetimet konsiderohen të plota përpilon relacionin shpjegues për faktin, provat, sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve, dhe ia dorëzon Prokurorit së bashku me fashikullin e procedimit penal.

8) Vlerësimi i punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit në seksione, bëhet nga Prokurori i rrethit dhe shefi i komisariatit një herë në vit,

***Detyra të përgjithshme.***

1) Në Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë ngrihet komisioni disiplinor. Në përbërje të tij marrin pjesë një prokuror, një oficer i policisë gjyqësore të seksionit dhe një oficer i policisë gjyqësore të shërbimeve, ky i fundit caktohet nga Shefi i Policisë Kriminale të Drejtorisë së Policisë së Qarkut.

Masat disiplinore dokumentohen në procesverbal të komisionit disiplinor dhe merren me shumicë votash. Vendimi për masat disiplinore dërgohet në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2) Jo më pak se një herë në muaj, nën drejtimin e drejtuesit të Prokurorisë së rrethit, organizohen takime të përbashkëta për të shqyrtuar ecurinë dhe problemet që mund të kenë në ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore.

Në këto takime duhet të marrin pjesë drejtuesit e Prokurorisë së rrethit dhe zëvendësat e tyre, Drejtori i Policisë së Qarkut, shefat e komisariateve dhe shefat e shërbimeve të policisë gjyqësore.

Për problemet që dalin dhe nuk marrin zgjidhje në këto takime mbahet procesverbal dhe Drejtuesi i Prokurorisë së bashku me Drejtorin e Policisë së Qarkut, informojnë Prokurorin e Përgjithshëm dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

3) Kur prokurori që ndjek procedimin penal dhe drejtuesi i shërbimeve të policisë gjyqësore e vlerësojnë të nevojshme, oficeret e policisë gjyqësore që kanë kryer hetimet marrin pjesë edhe gjatë seancave të hetimit gjyqësor në Gjykatë për të ndihmuar Prokurorin në paraqitjen e provave.

Policia Gjyqësore kur urdhërohet nga Gjykata ose Prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor të procesit penal, njofton dhe siguron pjesëmarrjen në gjyq të dëshmitarëve ose personave të tjerë të kërkuar prej tyre. Realizimi i kësaj detyre bëhet nga oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore që kanë marrë pjesë në hetimet paraprake.

4) Shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe seksionet e policive gjyqësore pranë Prokurorive, çdo tre muaj, shkëmbejnë informacione

ndërmjet tyre për çështje që lidhen me:

- Gjendjen e përgjithshme të kriminalitetit;
- tendencat më shqetësuese të tij;
- marrjen e masave parandaluese;
- si dhe çdo problem tjetër që është me interes në kuadrin e përgjithshëm të punës për parandalim dhe goditjen e kriminalitetit.

5) Shkëmbimi i ndërsjellë i informacioneve, ndërmjet shërbimeve të policive gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe seksioneve të policisë gjyqësore pranë prokurorive, realizohet për verifikime që lidhen me:

- implikime të reja për autorët apo autorë të tjerë të veprave penale;
- rrethana apo të dhëna të reja në funksion të procedimit penal;
- si dhe për marrjen e detyrimeve reciproke, të përbashkëta dhe /ose të bashkërenduara.

6) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, çdo vit, në bashkëpunim me drejtuesit e shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, planifikojnë dhe manin masa për organizimin, bashkërendimin dhe kryerjen e veprimtarive që kanë për qëllim edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm juridik e profesional të oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore.

7) Drejtorja e Përgjithshme e Policisë, Drejtorët e Policisë së Qarkut, Shefat e Komisariateve të marrin të gjitha masat e nevojshme për pajisje shërbimeve të Policisë Gjyqësore me bazën materiale të nevojshme.

8) Udhëzimet e përbashkëta nr. 63 dt. 27.04.2001, nr. 1620 dt. 16.01.2002, nr.10 dt. 17.01.2002 si dhe Urdhëri i Ministrit të Rendit Publik nr. 1621 dt. 16.01.2002 shfuqizohen.

9) Udhëzimi i përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i Ministrit të Rendit Publik hyn në fuqi në dt. 01.03.2003.

10) Moszbatimi i këtij udhëzimi kur nuk përbën vepër penale, përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

e P  
resj

MINISTRI I RENDIT PUBLIK  
LUAN RAMA




PROKURORI PËRGJITHSHËM  
THEODHORI SËLLAKU




7

